



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E ISTOGUT
Drejtoria për Arsim dhe Kulturë
05.Nr.1426/13
Datë: 09.12.2013



Në bazë të nenit 6 dhe 7 të Rregullores Komunale për bursa studentore nr. 2/2008,
Drejtori i Drejtorisë Komunale për arsim dhe kulturë, shpall:

K o n k u r s

Për ndarjen e 40(dyzet) bursave Komunale, studentore

Kushtet e konkursit

Për të realizuar të drejtën për bursë, studentet duhet të plotësojnë këto kushte:

- Të jenë studentë të rregullt, në një nga fakultetet publike në Republikën e Kosovës,
- Të jenë banorë të përhershëm të komunës së Istogut,
- Nota mesatare e periudhës së studimeve mbi shtatë,
- Suksesi i shkëlqyeshëm nga shkolla e mesme e lartë(për studentet që janë regjistruar në këtë vit shkollor)
- Mos të jenë shfrytëzues të bursës nga ndonjë burim tjetër,
- Në kushte të barabarta, përparësi do të kenë studentet nga familjet me kushte të vështira ekonomike-sociale, fëmijët e dëshmorëve, invalidëve, viktimave të luftës, fëmijët jetim dhe pa përkujdesje etj.
- Do të këtë edhe kritere shtesë që përcaktohet komisioni i veçantë para fillimit të shqyrtimit të dokumentacionit.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Vërtetimi i semestrit për vitin akademik të studimeve 2013/2014,
- Certifikata e notave,
- Vërtetimi që nuk shfrytëzon bursë universitare(vlen për studentet e vitit të dytë e tutje)
- Certifikata mbi gjendjen ekonomike,
- Kopja e letërnjoftimit,
- Studentet e vitit të parë sjellin kopjet e diplomës dhe dëftesave të SHML-së.

Aplikacionet(kërkesat) merren, plotësohen dhe dorëzohen në Drejtorinë Komunale për Arsim dhe kulturë. Afati i konkurrimit 15(pesëmbëdhjetë) ditë pune , nga dita e publikimit në gazetën “Zëri “ dhe në Web-faqen e komunës së Istogut.

Kërkesat e pa kompletuara me dokumentacion të nevojshëm dhe ato që arrin pas aftit, nuk do të shqyrtohen.

Drejtori i DAK-së, Agim Haxhiu _____